



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.10.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për ratifikimin e nryshimit nr.2 të marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi,ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, “Për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjëre dhe të qëndrueshme”
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport,ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë,që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe i përfaqësuar nga Ministria e Financave,dhe UNIKREDIT BANK AUSTRIA AG,për financimin e projektit të sistemit të ujërave të zeza të Bilishtit, “Kontratë me çelësa në dorë-Loti 1”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Armando Prenga, Mark Frroku, Vasilika Hysi, Tahir Muhedini, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Tom Doshi, Nard Ndoka, Silva Caka dhe Dashamir Peza.

Mungojnë:

Edi Paloka, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Kastriot Islami, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Eduard Halimi dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Elona Mistrovica – përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Stela Basha – Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Jovan Gjika – Drejtorja e Ujësjetës Kanalizimeve, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë me mbledhjen e komisionit. Pikë e parë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit Për ratifikimin e nryshimit nr.2 të marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi,ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, “Për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjëre dhe të qëndrueshme”. Të dëgjojmë znj.Mistrovica, përfaqësuese e Ministrisë së Financave për të bërë një prezantim të projektligjit.

Elona Mistrovica – Ky projektligj ka të bëjë me ndryshimin e marrëveshjes së grantit, lidhur me akordimin e një shume tjetër të ndihmës me vlerën prej 1 407 662 USD-sh, e cila i shtohet shumës ekzistuese të akorduar për vitin fiskal 2013. Këto fonde që i vihen në dispozicion qeverisë shqiptare do të alokohen në fushat përkatëse.

Fatmir Xhafaj – Relatorja, znj.Caka?

Silva Caka – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka. E hedhim në votim në parim. Kush është dakord? Dakord. Miratohet në parim. Neni 1. Dakord. Neni 2.Dakord. Jemi dakord në tërësi? Dakord. Ka kundra? Abstenim? Nuk ka. Miratohet projektligji edhe në tërësi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.10.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport,ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë,që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe i përfaqësuar nga Ministria e Financave,dhe UNIKREDIT BANK AUSTRIA AG,për financimin e projektit të sistemit të ujërave të zeza të Bilishtit, “Kontratë me çelësa në dorë-Loti 1”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Armando Prenga, Mark Frroku, Vasilika Hysi, Tahir Muhedini, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Tom Doshi, Nard Ndoka, Silva Caka dhe Dashamir Peza.

Mungojnë:

Edi Paloka, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Kastriot Islami, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Eduard Halimi dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Elona Mistrovica – përfaqësuese e Ministrisë së Financave

Stela Basha – Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Jovan Gjika – Drejtoria e Ujësjellës Kanalizimeve, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me projektligjin e dytë që kemi në rendin e ditës, “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport,ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë,që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe i përfaqësuar nga Ministria e Financave,dhe UNIKREDIT BANK AUSTRIA AG,për financimin e projektit të sistemit të ujërave të zeza të Bilishtit, “Kontratë me çelësa në dorë-Loti 1”. Një prezantim nga përfaqësuesit e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Jovan Gjika – Kjo marrëveshje ka si qëllim financimin e projektit të sistemit të ujërave të zeza të Bilishtit, “Kontratë me çelësa në dorë – Loti I”, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë.

Fatmir Xhafaj – Një kredi me terma të butë.

Jovan Gjika – Po me interes 0%.

Fatmir Xhafaj – Relatorja znj.Caka.

Silva Caka – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje, apo diskutime? Nuk ka. E hedhim në votim në parim. Kush është dakord në parim? Dakord. Neni 1. Miratohet. Neni 2.Miratohet. E hedhim në votim në tërësi. Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Dakord. Kundër? Abstenim? Nuk ka. Miratohet projektligji në tërësi.

MBLEDHJA MBYLLET